

VENDIM
Nr. 17/2016

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË DETAJUARA MBI ZBATIMIN E NDALIMEVE
TË PARASHIKUARA NË LIGJIN NR. 138/2015, “PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT
TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE
PUBLIKE”**

Në mbështetje të neneve 6/1 dhe 78 të Kushtetutës, si dhe të neneve 5, pika 2, 6 dhe 7, pika 5, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka për qëllim garantimin e zbatimit të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.

2. Objekt i këtij vendimi është përcaktimi i:

a) procedurave të detajuara për realizimin e verifikimit dhe për marrjen e masave për zbatimin e ndalimeve, sipas ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;

b) rregullave të detajuara dhe i afateve për plotësimin, dorëzimin, administrimin dhe publikimin e vetëdeklarimeve;

c) përmbajtjes, efekteve dhe modelit të formularit të vetëdeklarimit;

ç) përmbajtjes së kërkesës së një partie politike dhe modelit të formularit për verifikimin paraprak për kandidatura të mundshme të saj në zgjedhje apo organe kushtetuese ose të krijuara me ligj.

3. Organet e përfshira në procesin e verifikimit, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, sipas ligjit, ndjekin parimet e mëposhtme:

a) ligjshmërisë dhe procesit të rregullt ligjor;

b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;

c) objektivitetit, profesionalizimit dhe eficiencës;

ç) transparencës dhe rritjes së besimit të publikut në organet shtetërore;

d) pavarësisë dhe paanshmërisë.

4. Procesi i verifikimit, në çdo rast që është e mundur, duhet të synojë realizimin e tij në një kohë të mjaftueshme përpara kandidimit, votimit ose emërimit në funksionin publik, me qëllim administrimin e rregullt, transparencën dhe publikimin në kohë, kur kjo kërkohet, si dhe verifikimin e plotë e të gjithanshëm të të dhënave dhe nxjerrjen në kohë të përfundimeve të verifikimit, në funksion të pengimit të zgjedhjes apo emërimit, si dhe largimit nga funksioni publik.

KREU II. RREGULLAT E DETAJUARA DHE AFATET PËR PLOTËSIMIN, DORËZIMIN, ADMINISTRIMIN DHE PUBLIKIMIN E VETËDEKLARIMEVE

1. Subjektet që kandidojnë apo kërkojnë të zgjidhen/emërohen në një nga pozicionet e parashikuara në nenet 2 dhe 3, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, në të njëjtën kohë me kërkesën për kandidim në funksionin publik, janë të detyruar që të depozitojnë edhe formularin e vetëdeklarimit, sipas formatit të përcaktuar në kreun III të këtij vendimi.

2. Refuzimi për të dorëzuar formularin e vetëdeklarimit ose mosparaqitja e tij përbën shkak për moskandidim, mosemërim apo moszgjedhje në funksionin publik.

3. Në rastet kur procedura e kandidimit, zgjedhjes apo emërimit për pozicionet dhe subjektet e parashikuara në nenet 2 dhe 3, të ligjit, nuk përfshin detyrimin për depozitimin e një kërkesë formale nga subjekti, atëherë organi kompetent e njofton atë që, brenda 10 ditëve nga njoftimi, të depozitojë të plotësuar formularin e vetëdeklarimit, sipas këtij vendimi, me përjashtim kur parashikohet ndryshe me ligj. Nëse subjekti nuk depoziton formularin e vetëdeklarimit brenda afatit, konsiderohet se refuzon propozimin e organit kompetent për kandidim, zgjedhje apo emërim. Në këtë rast, organi kompetent ndërpret procedurën

për propozimin e këtij subjekti për t'u kandiduar, zgjedhur apo emëruar në atë funksion publik.

4. Formulari i vetëdeklarimit dorëzohet dhe administrohet nga:

a) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për funksionin e:

- i) deputetit të Kuvendit të Shqipërisë;
- ii) Kryeministrit apo anëtarit të Këshillit të Ministrave që nuk është deputet;
- iii) kryetarit të bashkisë apo këshilltarit në këshillin bashkiak.

b) Prefekti, për kandidatët në funksione publike që emërohen nga këshillat bashkiakë ose të qarkut.

c) Kryetari i Kuvendit, për drejtues apo anëtarë të organeve kushtetuese apo të krijuara me ligj që zgjidhen nga Kuvendi.

ç) Titullari apo organi që bën emërimin, për drejtues ose anëtarë të organeve kushtetuese apo të krijuara me ligj që nuk zgjidhen nga Kuvendi.

d) Organi përgjegjës për emërimin, transferimin dhe ngritjen në detyrë, për gjyqtarët ose prokurorët.

dh) Presidenti i Republikës, për:

i) përfaqësuesit e plotfuqishëm të Republikës së Shqipërisë në shtetet e tjera dhe në organizatat ndërkombëtare;

ii) Drejtorin e Shërbimit Informativ të Shtetit;

iii) Kryetarin e Akademisë së Shkencave dhe rektorët e universiteteve;

iv) Shefin e Shtabit të Përgjithshëm, si dhe komandantët e Forcave Tokësore, Detare dhe Ajrore;

v) çdo funksionar tjetër publik të emëruar prej tij, me përjashtim të Kryeministrit dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave.

e) Kryeministri, për zëvendësministrin, për pozicione të njëvlershme me të, Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit apo prefektin.

ë) Titullari apo organi që bën emërimin, për funksionarët politikë në kabinetet e drejtuesve të çdo institucioni kushtetues apo të krijuar me ligj.

f) Drejtuesi i Shërbimit Informativ Shtetëror apo drejtuesi i çdo shërbimi tjetër informativ, për punonjësit pranë këtyre shërbimeve.

g) Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, për punonjësit e Policisë së Shtetit.

gj) Departamenti i Administratës Publike, për nëpunës në shërbimin civil dhe shërbimin diplomatik, si dhe drejtues të çdo niveli në administratën publike të nivelit qendror dhe vendor që nuk përfshihet në shërbimin civil.

h) Ministri i Mbrojtjes, për ushtarakët e Forcave të Armatosura.

i) Ministri përgjegjës që ka nën përgjegjësi shoqërinë tregtare, për drejtuesit e kompanive që zotërohen plotësisht apo në maxhorancë ose administrohen nga shteti.

5. Secili prej organeve përgjegjëse për administrimin e formularit të vetëdeklarimit krijon një strukturë të posaçme ose cakton personat përgjegjës për regjistrimin, administrimin dhe përpunimin e formularit.

6. Përpara regjistrimit të formularit të vetëdeklarimit, struktura apo personi përgjegjës verifikon nëse ai është i plotësuar në të gjitha rubrikat e tij.

7. Nëse konstatohet se formulari i vetë-deklarimit është i paplotësuar apo pjesë të caktuara të tij janë të paplotësuara, struktura apo personi përgjegjës njofton subjektin dhe ia kthen atë mbrapsht, duke i caktuar edhe afatin e ri 5-ditor, brenda të cilit duhet të dorëzohet pa të meta. Nëse subjekti nuk dorëzon formularin e vetëdeklarimit të plotësuar, sipas konstatimeve fillestare të strukturës apo personit përgjegjës, ai konsiderohet se nuk e ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit.

8. Çdo formular vetëdeklarimi regjistrohet në regjistër me një numër unik identifikimi, si dhe ruhet e dokumentohet në rrugë elektronike.

9. Në çdo rast organi përgjegjës për administrimin merr masa për publikimin e vetë-deklarimeve në faqen zyrtare të tij në internet. Publikimi është i detyrueshëm. Organi përgjegjës, brenda muajit mars të çdo viti, informon Kuvendin dhe Prokurorin e Përgjithshëm, për numrin e personave që kanë rezultuar në kushtet e ndalimit, apo që nuk kanë dorëzuar formularin e vetëdeklarimit.

10. Formularët e vetëdeklarimit dhe të dhënat e përfshira në to mund të bëhen publike në çdo kohë dhe pa asnjë kufizim, para dhe pas datës së zgjedhjeve të përgjithshme apo vendore, votimeve në Kuvend apo emërimin, me kërkesë të subjekteve të interesuara. Kërkesa për marrjen e formularit të vetëdeklarimit dhe/ose të të dhënave të përfshira në të nuk mund të refuzohet apo kufizohet në asnjë rast.

KREU III. PËRMBAJTJA, EFEKTET DHE MODELI I FORMULARIT TË VETË-

DEKLARIMIT

1. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë të dhëna të plota mbi:

- a) gjenealogjinë e personit;
- b) ndryshimin apo përdorimin e një gjenealogji të ndryshëm nga ai aktual;
- c) vendbanimin apo vendqëndrimin e personit, brenda dhe jashtë Shqipërisë;
- d) rastet e ndalimit, arrestimit apo dënimit të personit, me vendim të formës së prerë ose jo, brenda dhe jashtë Shqipërisë;
- dh) rastet e dëbimit nga një shtet i huaj;
- dh) rastet e aplikimit ndaj tij të masave të sigurimit personal, në fuqi ose jo, apo dijenisë mbi ekzistencën e një urdhër kërkimi ndërkombëtar ndaj tij, brenda dhe jashtë Shqipërisë.

2. Në rastet kur ndonjë nga pjesët e formularit nuk mund të plotësohet, për mungesë të faktit, atëherë personi duhet të shënojë me vizë (/) atë pjesë, në mënyrë që të shmangët plotësimi apo rregullimi i mëvonshëm i saj.

3. Formulari i vetëdeklarimit përmban detyrimisht një rubrikë ku pasqyrohet se:

- a) Ky formular përbën dokument zyrtar dhe i nënshtrohet publikimit;
- b) Pasqyrimi i të dhënave të rreme në këtë formular përbën veprë penale dhe dënohet me burgim, sipas nenit 190 të Kodit Penal;
- c) Të dhënat e pasqyruara në të i nënshtrohen një verifikimi të plotë dhe të gjithanshëm, brenda dhe jashtë Shqipërisë, nga organet shtetërore dhe Prokuroria e Përgjithshme;
- ç) Pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta në të pasjell përjashtimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo nga funksioni publik;
- d) Shtetasi subjekt verifikimi është i detyruar të japë pëlqimin e tij për verifikimin e çdo të dhëne personale, përfshirë gjurmët daktiloskopike dhe çdo të dhënë tjetër biometrike. Në rast refuzimi të dhënies së pëlqimit, shtetasi trajtohet sikur të ketë rezultuar në një nga rrethanat që përbën kusht për ndalim.

4. Trajtimi i të dhënave të pasqyruara në formularin e vetëdeklarimit kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Në çdo rast, trajtimi në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale nuk përbën shkak për pengimin e publikimit të informacionit, në rast se personi emërohet apo zgjidhet në funksionin publik.

5. Modeli i formularit të vetëdeklarimit është sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6. Secili prej organeve përgjegjëse për administrimin e formularit të vetëdeklarimit, sipas kreut II të këtij vendimi, brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, publikon në faqen *web* të institucionit versionin elektronik të formularit të vetëdeklarimit. Ky format duhet të jetë i aksesueshëm lirisht nga publiku, të krijojë mundësinë për plotësimin e tij në mënyrë elektronike, si dhe i disponueshëm lirisht për printim.

7. Plotësimi i formularit të vetëdeklarimit duhet të bëhet në mënyrë të qartë dhe pa korrigjime që vështirësojnë kuptimin e të dhënave të pasqyruara në të. Në çdo rast, plotësimi bëhet në mënyrë individuale nga personi subjekt i ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

8. Subjekti, përpara plotësimit të formularit të vetëdeklarimit, ka të drejtë të kërkojë marrjen e dokumenteve apo të të dhënave pranë organeve kompetente, me qëllim garantimin e saktësisë së deklarimeve në formular.

Në këtë rast, organet kompetente shqyrtojnë me përparësi kërkesat e bëra në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Organet kompetente janë të detyruara të vendosin në dispozicion të subjektit dokumentet apo të dhënat, brenda 5 ditëve nga momenti i administrimit të kërkesës. Mosbashkëpunimi apo refuzimi për të vënë në dispozicion dokumentet apo të dhënat, pengesa apo vonesa, konsiderohet shkelje, sipas nenit 9, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Në çdo rast, mosdhënia e dokumenteve apo të dhënave ose vonesat në përgjigje, sipas kësaj pike, nuk përbën pengesë apo justifikim për mosdorëzimin ose mosplotësimin e formularit të vetëdeklarimit në afatet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

KREU IV. PËRMBAJTJA E KËRKESES SË NJË PARTIE POLITIKE DHE MODELI I FORMULARIT TË KËRKESES

1. Çdo parti politike e regjistruar, sipas legjisla-cionit në fuqi, ka të drejtë që t'i paraqesë Prokurorit të Përgjithshëm kërkesë për verifikim paraprak për kandidatura të mundshme të saj në zgjedhje apo organe kushtetuese ose të krijuara me ligj, me qëllim vlerësimin e ekzistencës së rrethanave që përbëjnë kusht ndalues, sipas ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

2. Me përjashtim të partive parlamentare, partitë e tjera politike, së bashku me kërkesën për verifikim paraprak, dorëzojnë edhe një kopje të akteve që provojnë regjistrimin e tyre, sipas legjisla-cionit në fuqi.

3. Kërkesa për verifikim paraprak përmban:

- a) Gjenealitetet e kërkuarit dhe të dhënat e plota të regjistrimit të partisë politike;
- b) Gjenealitetet e plota të shtetasit që është subjekt verifikimi;
- c) Pëlqimin e shtetasit që është subjekt verifikimi;
- d) Funkcionin publik, në të cilin pretendohet të kandidojë apo të emërohet shtetasi që është subjekt verifikimi;
- e) nënshkrimin e kryetarit të partisë apo të një personi të autorizuar prej tij, si dhe shtetasit që është subjekt verifikimi.

4. Kërkesa për verifikim paraprak mund të bëhet në çdo kohë, edhe jashtë periudhës zgjedhore apo jashtë periudhës kur është shpallur vendi vakant.

5. Modeli i kërkesës për verifikim paraprak është sipas aneksit 2, bashkëlidhur këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6. Kërkesa për verifikim paraprak shoqërohet me formularin e vetëdeklarimit, të plotësuar nga shtetasi që është subjekt verifikimi, sipas modelit të formularit të vetëdeklarimit dhe rregullave të përcaktuara në kreun III të këtij vendimi.

7. Rezultati i verifikimit paraprak mbetet konfidencial dhe i njoftohet vetëm kërkuarit dhe personit të verifikuar.

8. Prokuroria e Përgjithshme, brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, publikon në faqen *web* të institucionit versionin elektronik të kërkesës për verifikim paraprak. Ky format duhet të jetë i aksesueshëm lirisht nga publiku, të krijojë mundësinë për plotësimin e tij në mënyrë elektronike, si dhe i disponueshëm lirisht për printim.

KREU V. PROCEDURA E REALIZIMIT TË VERIFIKIMIT

1. Përpara fillimit të detyrës, emërimit apo zgjedhjes për një nga funksionet e parashikuara në nenet 2 dhe 3, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", organi përgjegjës për administrimin e formularit të vetë-deklarimit është i detyruar të verifikojë të dhënat e deklaruara nga personi.

2. Në rast se në formularin e vetëdeklarimit nuk është deklaruar asnjë e dhënë që ka të bëjë me:

i) dënime penale me vendim të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;

ii) dënime penale me vendim jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor i një shteti anëtar të BE-së, SHBA-së, Kanadasë, Australisë apo një shteti tjetër të përcaktuar me vendim të Kuvendit;

iii) masë sigurimi personal nga një autoritet gjyqësor i një shteti anëtar të BE-së, SHBA-së, Kanadasë, Australisë apo një shteti tjetër të përcaktuar me vendim të Kuvendit;

iv) urdhër kërkimi ndërkombëtar nga një autoritet gjyqësor i një shteti anëtar të BE-së, SHBA-së, Kanadasë, Australisë apo një shteti tjetër të përcaktuar me vendim të Kuvendit;

v) dëbime nga territori i një shteti anëtar të BE-së, SHBA-së, Kanadasë, Australisë apo një shteti tjetër të përcaktuar me vendim të Kuvendit;

organi përgjegjës për administrimin e formularit të vetëdeklarimit kryen kryesisht veprimet e mëposhtme:

a) Bën publik faktet e paraqitura në formularin e vetëdeklarimit;

b) Kërkon informacion pranë zyrës së gjendjes gjyqësore dhe zyrës së gjendjes civile;

c) Kërkon, brenda 5 ditëve, verifikimin e plotë nga Prokuroria e Përgjithshme të deklarimeve të bëra kur ka indicie mbi bazën e një kërkesë ose, kryesisht kur ka të dhëna apo fakte, përfshirë ato të njohura botërisht, për ekzistencën e të dhënave që kanë të bëjnë me:

i) dënime penale me vendim të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;

ii) dënime penale me vendim jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor i një shteti anëtar të BE-së,

SHBA-së, Kanadasë, Australisë apo një shteti tjetër të përcaktuar me vendim të Kuvendit;

iii) masë sigurimi personal nga një autoritet gjyqësor i një shteti anëtar të BE-së, SHBA-së, Kanadasë, Australisë apo një shteti tjetër të përcaktuar me vendim të Kuvendit;

iv) urdhër kërkimi ndërkombëtar nga një autoritet gjyqësor i një shteti anëtar të BE-së, SHBA-së, Kanadasë, Australisë apo një shteti tjetër të përcaktuar me vendim të Kuvendit;

v) dëbime nga territori i një shteti anëtar të BE-së, SHBA-së, Kanadasë, Australisë apo një shteti tjetër të përcaktuar me vendim të Kuvendit.

Procedura e verifikimit, sipas kësaj pike, nuk pengon vijimin e procedurave për zgjedhjen, emërimin apo ushtrimin e funksionit.

3. Në rast se në formularin e vetëdeklarimit janë deklaruar të dhëna që kanë të bëjnë me:

i) dënime penale me vendim të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;

ii) dënime penale me vendim jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor i një shteti anëtar të BE-së, SHBA-së, Kanadasë, Australisë apo një shteti tjetër të përcaktuar me vendim të Kuvendit;

iii) masë sigurimi personal nga një autoritet gjyqësor i një shteti anëtar të BE-së, SHBA-së, Kanadasë, Australisë apo një shteti tjetër të përcaktuar me vendim të Kuvendit;

iv) urdhër kërkimi ndërkombëtar nga një autoritet gjyqësor i një shteti anëtar të BE-së, SHBA-së, Kanadasë, Australisë apo një shteti tjetër të përcaktuar me vendim të Kuvendit;

v) dëbime nga territori i një shteti anëtar të BE-së, SHBA-së, Kanadasë, Australisë apo një shteti tjetër të përcaktuar me vendim të Kuvendit;

organi përgjegjës për administrimin e formularit të vetëdeklarimit kryen veprimet e mëposhtme:

a) bën publik faktet e paraqitura në formularin e vetëdeklarimit;

b) verifikon nëse ndonjë nga rrethanat e paraqitura përfshihet brenda sferës së ndalimeve të parashikuara nga ligji:

i) nëse konstaton se ndonjë nga të dhënat përfshihet brenda sferës së ndalimeve, të parashikuara nga neni 2, i ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ndërpret verifikimet e mëtejshme dhe aplikon masat e parashikuara nga ligji për pengimin e zgjedhjes ose emërimit apo largimit nga funksioni publik të personit;

ii) nëse konstaton *prima facie* se të dhënat nuk përfshihen brenda sferës së ndalimeve, të parashikuara nga neni 2, i ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ia kalon rastin për kontroll të thelluar, brenda 5 ditëve, Prokurorisë së Përgjithshme, për të veri-fikuar saktësinë e të dhënave të pasqyruara dhe për të konstatuar nëse rrethanat janë të ndryshme dhe se personi është subjekt i ndalimeve, sipas ligjit;

c) Kërkon informacion pranë zyrës së gjendjes gjyqësore dhe zyrës së gjendjes civile;

ç) Kërkon, brenda 5 ditëve, verifikimin e plotë nga Prokuroria e Përgjithshme të deklarimeve të bëra kur ka indicie, mbi bazën e një kërkese ose, kryesisht kur ka të dhëna apo fakte, përfshirë ato të njohura botërisht për ekzistencën e të dhënave të tjera që kanë të bëjnë me:

i) dënime penale me vendim të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;

ii) dënime penale me vendim jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor i një shteti anëtar të BE-së, SHBA-së, Kanadasë, Australisë apo një shteti tjetër të përcaktuar me vendim të Kuvendit;

iii) masë sigurimi personal nga një autoritet gjyqësor i një shteti anëtar të BE-së, SHBA-së, Kanadasë, Australisë apo një shteti tjetër të përcaktuar me vendim të Kuvendit;

iv) urdhër kërkimi ndërkombëtar nga një autoritet gjyqësor i një shteti anëtar të BE-së, SHBA-së, Kanadasë, Australisë apo një shteti tjetër të përcaktuar me vendim të Kuvendit;

v) dëbime nga territori i një shteti anëtar të BE-së, SHBA-së, Kanadasë, Australisë apo një shteti tjetër të përcaktuar me vendim të Kuvendit.

4. Në çdo rast, organi përgjegjës për administrimin e formularit të vetëdeklarimit kërkon verifikimin nga Prokuroria e Përgjithshme të të dhënave të paraqitura, nëse kërkohet nga një prej subjekteve që gëzojnë të drejtën e nismës për verifikimin e të dhënave, sipas nenit 7, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Në këtë rast, organi përgjegjës specifikon edhe të dhënat e subjektit që ka kërkuar verifikimin, duke i bashkëlidhur edhe një kopje të kërkesës.

Kërkuesi gjohet me 100 000 lekë kur, pas kryerjes së verifikimit, kërkesa dukshëm është kryer me të dhëna të pavërteta. Në këtë rast, paraqitja e të dhënave dukshëm të pavërteta konsiderohet rasti kur

provohet se kërkuesi me dashje ka krijuar të dhëna të rreme, pa pasur asnjë indicie për ekzistencën reale të tyre dhe, pavarësisht rezulta-teve të verifikimit, ripërsërit të njëjtën kërkesë, bazuar në të njëjtat fakte e prova.

5. Për efekt të verifikimit nëse personi është apo jo në kushtet e ndalimeve, sipas neneve 2 dhe 3, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Prokuroria e Përgjithshme vepron si më poshtë:

a) Për personat e dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë:

i) administrohet në rrugë zyrtare një kopje e vendimit gjyqësor të formës së prerë;

ii) verifikohet nëse dënimi është dhënë për ndonjë nga veprimet apo mosveprimet që përmbajnë veprat penale të përmendura në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;

iii) përfundimet e procesit të verifikimit, që realizohet sipas neneve 8 dhe 16, pika 4, të ligjit nr. 138/2015, i përcillen organit përgjegjës brenda 3 ditëve nga përfundimi i tyre.

b) Për personat e dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë:

i) administrohet në rrugë zyrtare një kopje e vendimit gjyqësor të formës së prerë;

ii) verifikohet nëse dënimi është dhënë për kryerjen e një veprimi apo mosveprimi që përbën krim, sipas dispozitave të Kodit Penal aktual dhe që nuk përfshihet në rrethin e veprave penale të parashikuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;

iii) përfundimet e procesit të verifikimit, që realizohet sipas neneve 8 dhe 16, pika 4, të ligjit nr. 138/2015, i përcillen organit përgjegjës brenda 3 ditëve nga përfundimi i tyre.

c) Për personat e dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë:

i) administrohet në rrugë zyrtare një kopje e vendimit gjyqësor të formës së prerë;

ii) verifikohet nëse dënimi është dhënë për kryerjen e një veprimi apo mosveprimi që përbën krim, sipas dispozitave të Kodit Penal aktual dhe që nuk përfshihet në rrethin e veprave penale të parashikuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;

iii) përfundimet e procesit të verifikimit, që realizohet sipas neneve 8 dhe 16, pika 4, të ligjit nr. 138/2015, i përcillen organit përgjegjës brenda 3 ditëve nga përfundimi i tyre.

ç) Për personat e dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor i një shteti anëtar të BE-së, SHBA-së, Kanadasë, Australisë:

i) administrohet në rrugë zyrtare një kopje e vendimit gjyqësor jopërfundimtar;

ii) verifikohet autoriteti gjyqësor që e ka dhënë atë dhe nëse ai është organ i një prej shteteve anëtare të BE-së, SHBA-së, Kanadasë, Australisë apo një shteti tjetër të përcaktuar me vendim të Kuvendit;

iii) verifikohet nëse dënimi është dhënë për kryerjen apo tentativën e kryerjes së ndonjë prej veprimeve apo mosveprimeve që përmbajnë veprat penale të përmendura në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;

iv) përfundimet e procesit të verifikimit, që realizohet sipas neneve 8 dhe 16, pika 4, të ligjit nr. 138/2015, i përcillen organit përgjegjës brenda 3 ditëve nga përfundimi i tyre.

d) Për personat, ndaj të cilëve është vendosur një masë sigurimi personal dhe/ose është lëshuar një urdhër kërkimi ndërkombëtar nga një autoritet gjyqësor i një shteti anëtar të BE-së, SHBA-së, Kanadasë, Australisë apo një shteti tjetër të përcaktuar me vendim të Kuvendit:

i) administrohet në rrugë zyrtare një kopje e vendimit apo aktit, me të cilin është vendosur masa e sigurimit personal dhe/ose është lëshuar urdhri i kërkimit ndërkombëtar;

ii) verifikohet autoriteti që e ka dhënë atë dhe nëse ai është organ i një prej shteteve anëtare të BE-së, SHBA-së, Kanadasë, Australisë apo një shteti tjetër të përcaktuar me vendim të Kuvendit;

iii) verifikohet nëse masa e sigurimit personal dhe/ose urdhri i kërkimit ndërkombëtar është dhënë për kryerjen apo tentativën e kryerjes së ndonjë nga veprimet ose mosveprimet që përmbajnë veprat penale të përmendura në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;

iv) përfundimet e procesit të verifikimit, që realizohet sipas neneve 8 dhe 16, pika 4, të ligjit nr. 138/2015, i përcillen organit përgjegjës brenda 3 ditëve nga përfundimi i tyre.

dh) Për personat që janë dëbuar nga territori i një shteti anëtar të BE-së, SHBA-së, Kanadasë, Australisë apo një shteti tjetër të përcaktuar me vendim të Kuvendit:

i) administrohet në rrugë zyrtare një kopje e vendimit apo aktit, me të cilin është urdhëruar dëbimi;

ii) verifikohet autoriteti që e ka dhënë atë dhe nëse ai është organ i një prej shteteve anëtare të BE-së, SHBA-së, Kanadasë, Australisë apo një shteti tjetër të përcaktuar me vendim të Kuvendit.

iii) verifikohet nëse dëbimi është dhënë për:

- kryerjen apo tentativën e kryerjes së ndonjë nga veprimet apo mosveprimet që përmbajnë veprat penale të përmendura në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;

- krime të përfshira në rastet e shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;

- cenim shumë të rëndë dhe serioz të sigurisë publike të shtetit përkatës. Në këtë rast, me cenim shumë të rëndë dhe serioz të sigurisë publike nënkuptohen rastet kur autoritetet kompetente të shtetit përkatës kanë pasur dyshime për përfshirjen e personit në veprimtari kriminale apo për prishjen prej tij të rendit dhe sigurisë publike;

iv) përfundimet e procesit të verifikimit, që realizohet sipas neneve 8 dhe 16, pika 4, të ligjit nr. 138/2015, i përcillen organit përgjegjës brenda 3 ditëve nga përfundimi i tyre.

6. Kushtet e ndalimeve, sipas neneve 2 dhe 3, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, zbatohen edhe ndaj personave që, në kohën e dhënies së vendimit të dënimit apo masës së sigurimit, urdhrit ndërkombëtar të kërkimit apo dëbimit, mbanin të dhëna identiteti të ndryshme nga ato që mbajnë në momentin kur kryhet verifikimi.

Për efekt provueshmërie që personi që ka plotësuar formularin e vetëdeklarimit është i njëjti me personin:

i) e dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;

ii) e dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar;

iii) ndaj të cilit është vendosur një masë sigurimi personal dhe/ose është lëshuar një urdhër kërkimi ndërkombëtar;

iv) e dëbuar;

verifikohen dhe administrohen:

a) Të dhënat e gjendjes civile, në mënyrë të drejtpërdrejtë, në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile apo në Zyrën e Gjendjes Civile ku rezulton i regjistruar personi;

b) Gjurmët daktiloskopike dhe çdo e dhënë tjetër biometrike që ruhet në bazat e të dhënave të identifikimit të shtetasve shqiptarë apo që ruhen nga autoritetet kompetente, brenda dhe jashtë Shqipërisë, nëpërmjet metodës së krahasimit të tyre;

c) Të dhëna apo akte të tjera që provojnë përdorimin nga personi:

i) të një identiteti tjetër ku pasqyrohen gjenea-litete të pandryshuara në rrugë zyrtare;

ii) dokumente identifikimi të falsifikuara.

7. Për kryerjen e verifikimeve, Prokuroria e Përgjithshme përdor:

a) Çdo të dhënë apo dokumentacion në dispo-zicion të saj;

b) Çdo të dhënë apo dokumentacion që dispo-nojnë organet apo entitetet e tjera shtetërore, brenda apo jashtë vendit, duke kërkuar marrjen zyrtarisht dhe administrimin e një kopjeje të tyre. Çdo organ shtetëror apo person juridik, publik ose privat, brenda vendit, ka detyrimin që të bashkë-punojë me organet e ngarkuara nga ky ligj për verifikimin e të dhënave, fakteve dhe rrethanave të deklaruara prej shtetasve;

c) Gjurmët daktiloskopike dhe çdo të dhënë tjetër biometrike;

ç) Indicie apo fakte të bëra publike, të cilat i nënshtrohen kontrollit, gjurmimit dhe dokumen-timit;

d) Kërkesat për verifikime të hollësishme pranë organeve të juridiksioneve të huaja, kur ka informacione dhe është e nevojshme që verifikimi të kryhet edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Në këtë kuadër, Prokurori i Përgjith-shëm autorizohet të nënshkruajë edhe marrëveshje bashkëpunimi me autoritetet gjyqësore të vendeve të tjera, në funksion të lehtësimit të marrjes së informacioneve, të të dhënave apo dokumenteve që disponohen prej tyre;

dh) Çdo të dhënë, fakt apo provë që ndihmon në arritjen e konkluzioneve të sakta për rastin nën verifikim.

8. Gjatë procedurës së verifikimit, Prokuroria e Përgjithshme dokumenton çdo të dhënë, akt apo fakt të administruar gjatë procedurës, si dhe rezultatet e verifikimit dhe të dhënat e grumbulluara i ruan në një sistem elektronik të krijuar për këtë qëllim.

9. Verifikimi përmbillet brenda një afati 3-mujor nga momenti i ardhjes së kërkesës për verifikim, me përjashtim të rasteve kur Prokurori i Përgjithshëm vendos zgjatjen e këtij afati, kur është e nevojshme që të pritet përgjigje ndaj kërkesave për verifikime të hollësishme pranë organeve të juridiksioneve të huaja, kur ka informacione dhe është e nevojshme që verifikimi të kryhet edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

10. Kur konkludohet se verifikimi është kryer i plotë dhe i gjithanshëm apo se nuk ekzistojnë më metoda ose mënyra të reja për realizimin e verifikimeve të tjera, Prokurori i Përgjithshëm me vendim miraton rezultatet e verifikimit.

11. Brenda 3 ditëve nga përfundimi i verifikimit dhe miratimit të rezultateve, Prokurori i Përgjithshëm ia njofton ato organit përgjegjës për zbatimin e ndalimeve, sipas ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Nëse verifikimi është bërë me kërkesë të një prej subjekteve që gëzojnë të drejtën e nismës për verifikimin e të dhënave, sipas nenit 7, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Prokurori i Përgjithshëm ia njofton rezultatet e verifikimit edhe subjektit kërkuar.

12. Organi përgjegjës, pasi merr rezultatet nga Prokurori i Përgjithshëm, shqyrton nëse janë evidentuar nga procesi i verifikimit të dhëna që përfshihen brenda sferës së ndalimeve, të parashikuara nga neni 2, i ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

13. Nëse ekzistojnë të dhëna që përfshihen brenda sferës së ndalimeve, të parashikuara nga neni 2, i ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, organi përgjegjës verifikon nëse ato përfshihen brenda periudhës së ndalimit, të përcaktuar në nenin 4, të ligjit nr. 138/2015.

14. Nëse të dhënat përfshihen brenda periudhës së ndalimit, organi përgjegjës, brenda 10 ditëve nga përfundimi i rezultateve të verifikimit, zbaton masat për pengimin e zgjedhjes ose emërimit apo largimit nga funksioni publik të personit, sipas rregullave të përcaktuara në nenet 10, 13 dhe 14, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

KREU VI. PROCEDURA PËR VETË-DEKLARIMIN NGA FUNKSIONARËT PUBLIKË AKTUALË

1. Funkionarët publikë, që janë subjekt i neneve 2 dhe 3, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, që janë aktualisht në detyrë, brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, janë të detyruar të depozitojnë formularin e vetëdeklarimit pranë organit përgjegjës, të përcaktuar në kreun II të këtij vendimi.

2. Çdo formular vetëdeklarimi regjistrohet në regjistër me një numër unik identifikimi, si dhe ruhet e dokumentohet në rrugë elektronike. Nëse konstatohet se formulari i vetëdeklarimit është i paplotësuar apo pjesë të caktuara të tij janë të paplotësuara, struktura apo personi përgjegjës njofton subjektin dhe ia kthen atë mbrapsht, duke i caktuar edhe afatin e ri 5-ditor, brenda të cilit duhet të dorëzohet pa të meta. Nëse subjekti nuk dorëzon formularin e vetëdeklarimit, të plotësuar sipas konstatimeve fillestare të strukturës apo personit përgjegjës, ai konsiderohet se nuk e ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit.

3. Organet përgjegjëse, brenda 15 ditëve nga skadimi i afatit, sipas pikës 1 të këtij kreu, bëjnë publike listën e funksionarëve publikë që kanë depozituar formularët e vetëdeklarimit pranë tyre. Si rregull, në çdo rast, organi përgjegjës për administrimin merr masa për publikimin e vetëdeklarimeve në faqen zyrtare të tij në internet. Publikimi është i detyrueshëm nëse kërkohet nga një subjekt i interesuar.

4. Brenda 5 ditëve nga skadimi i afatit, sipas pikës 1 të këtij kreu, organi përgjegjës evidenton funksionarët publikë që nuk kanë depozituar formularët e vetëdeklarimit. Në këtë rast, organi përgjegjës e trajton këtë rast si refuzim për të deklaruar dhe personi trajtohet sikur të ketë rezultuar në një nga rrethanat që përbën kusht për ndalimin e zgjedhjes apo emërimit të tij në funksionin publik.

5. Brenda 3 muajve nga skadimi i afatit, sipas pikës 1 të këtij kreu, organi përgjegjës për administrimin e formularit të vetëdeklarimit është i detyruar të verifikojë të dhënat e deklaruara nga personi dhe kryen të gjitha veprimet dhe procedurat e parashikuara në kreun V të këtij vendimi.

6. Organi përgjegjës për administrimin e formularit të vetëdeklarimit dhe verifikimin e të dhënave zbaton rregullat e përcaktuara në krerët II dhe V të këtij vendimi.

7. Prokuroria e Përgjithshme kryen verifikimet për funksionarët publikë aktualë, sipas të njëjtave rregulla të parashikuara në kreun V të këtij vendimi.

8. Brenda 10 ditëve nga përfundimi i rezultateve të verifikimit, nëse provohet se ekzistojnë rrethanat

për ndalimin e zgjedhjes apo emërimit, organi përgjegjës zbaton procedurat e nevojshme kushtetuese apo ligjore për mbarimin e mandatit apo shkarkimin nga detyra, sipas nenit 15, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

KREU VII. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Secili prej organeve përgjegjëse për administrimin e formularit të vetëdeklarimit, brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi:

a) Krijon një strukturë të posaçme ose cakton personat përgjegjës për regjistrimin, administrimin dhe përpunimin e formularit;

b) Krijon regjistrin për regjistrimin e formularëve të vetëdeklarimit dhe merr masa për të siguruar ruajtjen dhe dokumentimin e tij në rrugë elektronike;

c) Merr masa për të siguruar publikimin e vetëdeklarimeve në faqen zyrtare të tij në internet.

2. Prokurori i Përgjithshëm, brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi:

a) Krijon një strukturë të posaçme pranë Prokurorisë së Përgjithshme për zbatimin e detyrimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe në këtë vendim;

b) Krijon regjistrin për regjistrimin e kërkesave për verifikim;

c) Merr masa për të siguruar ruajtjen dhe dokumentimin edhe në një sistem elektronik të:

i) kërkesave për verifikim;

ii) çdo të dhënë, akt apo fakt të administruar gjatë procedurës së verifikimit;

iii) rezultateve të verifikimit dhe të dhënave të grumbulluara.

3. Këshilli i Ministrave i siguron Prokurorisë së Përgjithshme buxhetin e nevojshëm për të mbuluar çdo shpenzim financiar të nevojshëm për përmbushjen e përgjegjësive, sipas ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 4.3.2016



FORMULAR VETËDEKLARIMI

PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 138/2015 “PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE”

DATE: ___ / ___ / ___

I. TË DHËNAT PERSONALE

A. Gjeneralitetet aktuale

| | |
|------------|--|
| EMËR | |
| MBIEMËR | |
| ATËSI | |
| AMËSI | |
| DATËLINDJE | |
| VENDLINDJE | |
| VENDBANIM | |
| NR. ID | |

B. Gjeneralitete të mëparshme

(Nëse keni ndryshuar zyrtarisht ndonjë nga të dhënat e gjeneralitetit tuaj, apo keni përdorur një gjeneralitet tjetër, qoftë edhe pa e ndryshuar zyrtarisht, listoni secilin prej tyre, duke plotësuar të gjitha të dhënat që janë ndryshuar dhe aq herë sa janë ndryshuar. *Mosdeklarimi i ndonjë gjeneraliteti sipas kësaj pike, që mund të pengojë verifikimin sipas dispozitave të ligjit nr. 138/2015, përbën vepër penale sipas nenit 190 të Kodit Penal.*)

| | |
|------------|--|
| EMËR | |
| MBIEMËR | |
| ATËSI | |
| AMËSI | |
| DATËLINDJE | |
| VENDLINDJE | |

(emër, mbiemër, nënshkrim)

II. MARRJE DIJENI MBI EFEKTET E FORMULARIT TË VETËDEKLARIMIT

Unë, i/e nënshkruari /a _____, kam marrë dijeni dhe jam i vetëdijshëm se:

- a) Ky Formular përbën dokument zyrtar që i drejtohet një organi shtetëror dhe i nënshtrohet verifikimit dhe publikimit.
- b) Pasqyrimi i të dhënave të rreme në këtë Formular përbën veprë penale dhe dënohet me burgim sipas nenit 190 të Kodit Penal.
- c) Të dhënat e pasqyruara në këtë Formular i nënshtrohen verifikimit të plotë, brenda dhe jashtë Shqipërisë, nga organet shtetërore dhe Prokuroria e Përgjithshme.
- ç) Me plotësimin e këtij Formulari, kam dhënë pëlqimin për verifikimin e çdo të dhëne personale, përfshirë gjurmët daktiloskopike dhe çdo të dhënë tjetër biometrike.
- d) Pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta në këtë Formular dhe refuzimi i depozitimit të gjurmëve daktiloskopike, passjell skualifikimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo ushtrimi i mëtejshëm i funksionit publik.
- e) Trajtimi i të dhënave do të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke qenë i vetëdijshëm për pasojat ligjore në rast të deklarimeve të pavërteta, të paplota apo të pasakta, konfirmoj saktësinë e të dhënave të pasqyruara në këtë Formular.

KUJDES: JENI I/E SIGURT? SUGJEROHET QË NËNSHKRIMI I KËTIJ SEKSIONI TË BËHET PASI ËSHTË PLOTËSUAR SAKTË I GJITHË FORMULARI!

(emër, mbiemër, nënshkrim)

(emër, mbiemër, nënshkrim)

III. TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT

1. **A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj? (Vendos X përbri përgjigjes)**

PO JO

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

| Të dhënat e vendimit gjyqësor | | | | |
|-------------------------------|---|--------------------------|---------------------------------------|-------|
| Gjykata | Nr. dhe data e vendimit gjyqësor të formës së prerë | Masa e dënimit me burgim | Vepra penale për të cilën jeni dënuar | |
| | | | Neni | Lloji |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |

2. **A jeni dënuar me burgim me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj, për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë? (Vendos X përbri përgjigjes)**

PO JO

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

| Të dhënat e vendimit gjyqësor | | | | |
|--|---------|---------------------------------------|-------|-----------------------------|
| Të dhënat e vendimit gjyqësor jopërfundimtar | Gjykata | Vepra penale për të cilën jeni dënuar | | Vendimi përfundimtar/Dënimi |
| | | Neni | Lloji | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |

(emër, mbiemër, nënshkrim)

3. A keni qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj, për kryerjen e një vepre penale? (Vendos X përbri përgjigjes)

PO JO

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

| Organi procedues | Qyteti, Shteti | Arsyet | Periudha/Data | Rezultatet |
|------------------|----------------|--------|---------------|------------|
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |

4. A keni qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale? (Vendos X përbri përgjigjes)

PO JO

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

| Organi procedues | Qyteti, Shteti | Arsyet | Periudha/Data | Rezultatet |
|------------------|----------------|--------|---------------|------------|
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |

5. A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo? (Vendos X përbri përgjigjes)

PO JO

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

(emër, mbiemër, nënshkrim)

| MASAT SHTRËNGUESE TË SIGURISË | PËRGJIGJE | |
|---|--------------------------|--------------------------|
| | Aktualisht në fuqi | E revokuar |
| Ndalimi i daljes jashtë shtetit | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| Ndalimi dhe detyrimi i qëndrimit në një vend të caktuar | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| Garancia pasurore | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| Arresti në shtëpi | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| Arresti në burg | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| Shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

| Gjykata | Qyteti, shteti | Vepra penale për të cilën akuzoheshit | | Vendimi përfundimtar | Periudha, data |
|---------|----------------|---------------------------------------|-------|----------------------|----------------|
| | | Neni | Lloji | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |

6. A është lëshuar ndonjëherë ndaj personit tuaj një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale? (Vendos X përbrë përgjigjes)

PO JO

Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

| Autoriteti urdhërues | Arsyeja | Qyteti, Shteti | Ekzekutimi (nëse është në fuqi apo jo) |
|----------------------|---------|----------------|--|
| | | | |
| | | | |
| | | | |

7. A është marrë ndonjëherë për ju masa e dëbimit nga një shtet i huaj?

(Me përjashtim të rastit kur jeni dëbuar ekskluzivisht për shkëlqen e rregullave të emigracionit që kanë të bëjnë me rregullat e qëndrimit apo hyrje-daljes në një territor të një shteti të huaj) (Vendos X përbrë përgjigjes)

PO JO

(emër, mbiemër, nënshkrim)

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

| Qyteti dhe Shteti ku keni jetuar | Arsyeja dëbimit | Periudha e dëbimit nga shteti i huaj | Të dhanat e aktit të dëbimit |
|----------------------------------|-----------------|--------------------------------------|------------------------------|
| | | | |
| | | | |
| | | | |

8. A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj? (Vendos X përmbri përgjigjes)

PO JO

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

| Qyteti dhe Shteti ku keni jetuar | Arsyeja | Periudha | Adresa e vendqendrimit |
|----------------------------------|---------|----------|------------------------|
| | | | |
| | | | |
| | | | |

Duke qenë i vetëdijshëm për pasojat ligjore në rast të deklarimeve të pavërteta, të paplota apo të pasakta, konfirmoj saktësinë e të dhënave të pasqyruara në këtë Formular.

(emër, mbiemër, nënshkrim)

Shënim: Në rast referimi të akteve, vendimeve dhe dokumenteve të caktuara, bashkëngjithini një kopje të tyre këtij Formulari.

Nëse pjesë të caktuara të Formularit janë të pamjaftueshme për deklarin e të dhënave, shto aq pjesë sa ju nevojiten për pasqyrimin e të gjitha të dhënave.

(emër, mbiemër, nënshkrim)

KËRKESË PËR VERIFIKIM PARAPRAK

NË KUADËR TË ZBATIMIT TË LIGJIT NR. 138/2015 "PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE"

DATE: ____/____/____

STEMA

PARTIA _____
KRYETARI

DREJTUAR: PROKURORISË SË PËRGJITHSHME

BAZA LIGJORE: Pika 5 e nenit 7 të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", si dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

I nderuar z. Prokuror i Përgjithshëm,

Unë _____, Kryetar/person i autorizuar i Partisë _____, regjistruar me vendimin e _____, nr. _____, datë _____, me seli në _____, kërkoj kryerjen e verifikimit paraprak në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për shtetasin me të dhënat e mëposhtme:

| | |
|------------|--|
| EMËR | |
| MBIEMËR | |
| ATËSI | |
| AMËSI | |
| DATËLINDJE | |
| VENDLINDJE | |
| VENDBANIM | |
| NR. ID | |

Partia _____ ka të drejtën e caktimit të:

(specifiko funksionin publik)

Shtetasi _____ është kandidat potencial për këtë pozicion dhe jep pëlqimin për t'iu nënshtruar verifikimit paraprak.

Në këtë kuadër, me pëlqimin e vetë subjektit, kërkojmë verifikimin e saktësisë së të dhënave të pasqyruara në Formularin e Vetëdeklarimit, bashkëlidhur kësaj kërkesë, dhe ekzistencën ose jo të rrethanave/fakteve/të dhënave që përbëjnë kusht ndalues sipas ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Rezultatet e këtij verifikimi paraprak të dërgohen në adresat e mëposhtme:

PARTIA: _____

Adresa: _____

SUBJEKTI: _____

Adresa: _____

Me respekt,

KRYETARI (ose PERSONI I AUTORIZUAR¹)

(emër, mbiemër)

(nënshkrimi, vula)

SUBJEKTI NË VERIFIKIM

(emër, mbiemër)

(nënshkrimi)

¹ Autorizuar me aktin nr. _____, datë _____, të Kryetarit të Partisë _____ një kopje të të cilit e gjeni bashkëlidhur.

